



Buletini nr. 162- Maj- 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Buletini nr. 162- Maj - 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Fillimi i ndërtimit të shkollave në Lladrovç dhe Bardh



Përmbajtja:

KK i Malishevës, shqyrtoi raportin e punës së Kryetarit të Komunës.....	4
KK i Malishevës, jep në shfrytëzim për një vit pishinat në Banjë	5
Në ditën e shkollës, filloi ndërtimi i fushës së sportit në Turjakë.....	5
Qendra e Kompetencës Malishevë, për shtatë vjet punë arriti të krijoj shkencëtarë	6
Maturantët e Malishevës, e përmyllin javën e maturës, me plis në kokë	7
Ngricat e prillit, 27 fermerëve ju kanë bërë rreth pesëqind mijë euro dëme	7
Rregullohet infrastruktura në Carrallukë.....	8
Begaj u takua me ambasadorin e Kuvajtit në Shqipëri	9
Vazhdon realizimi i projekteve kapitale dhe rregullimi i infrastrukturës	10
Filloi hapja dhe rregullimi i rrugës, që lidh Burimin dhe Gurbardhin	10
Drejtoresha Krasniqi, uron atletet malishevase	11
Përfunduan garat shkollore komunale në sport.....	12
Shkolla e Berishës, shënoi 54 vjetorin e hapjes.....	12
Kryetari Begaj, vizito punimet në Lladrovç e Llapçevë	13
Në Carrallukë, u përrua objekti i Shtëpisë së Kulturës	14
Komiteti për shëndetësi, vizitoi QKMF-në në Malishevë	15
Shpërndahen njëqind makina mjelëse për fermerët malishevas.....	15
Filloi fushata e spërkatjes së zonave endemike në Malishevë	16
Njoftim: Prej nesër aparati i mamografisë në shërbim të qytetarëve të Malishevës	17
KK i Malishevës, miratoi rishikimin e buxhetit komunal për këtë vit	17
BE përkrahë tri biznese në Malishevë.....	18
Malisheva, pjesë e “Projekti-Socio”	19
Nxënësit e klasave të nënta sot i nënshtrohen testit të arritshmërisë	20
Komiteti për Komunitete, miratoi raportin e punës për vitin e kaluar	20
Kanalizimi në Mleqan, drejt finalizimit	21



Familja Zogaj nga Llazica, bëhet më shtëpi të re	21
Parafilloristët, vizituan Drejtorinë për Arsim dhe Edukim Malishevë	22
Filloi ndërtimi i rrugës që lidh dy lagje të Denocit	22
Filloi ndërtimi i shkollave në Lladrovç dhe Bardh	23
Edhe familja Sertolli bëhet me shtëpi banimi.....	24



KK i Malishevës, shqyrtoi raportin e punës së Kryetarit të Komunës

Malishevë, 2 maj

Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka vazhduar sot mbledhjen e katër të rregullt, e cila përsëri nuk ka mundur të përfundoj punimet, dhe do të vazhdoj edhe ditën e nesërme. Në këtë mbledhje, në mesin e pikave për shqyrtim, ishte edhe raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale, për periudhën janar-dhjetor 2016.



Raportin vjetor të punës, para anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës, e ka prezantuar kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Në paraqitjen e raportit, kryetari Begaj i ka përmendur të arriturat, investimet dhe realizimin e objektivave, gjatë vitit 2016. Investimet në infrastrukturë shkollore, atë rrugore, rrjete kanalizimi dhe ujësjellës, pastaj investimet në bujqësi, ishin karakteristikat e qeverisjes gjatë vitit 2016. Ndërsa sukses i madh u përmend edhe luftimin i EHKK. Sfidë e vitit të kaluar, kanë qenë vërshimet dhe dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Në shqyrtimin e raportit, anëtarët e Kuvendit të Komunës, e kanë përgëzuar kryetarin për të gjitha punët e kryera, por kanë dhënë edhe vërejtje, në cilësinë e disa prej projekteve, pasi sipas tyre, cilësia e projekteve të realizuara duhet të përmirësohet.

Në mbledhjen e sotme, anëtarët e KK të Malishevës, ka miratuar edhe disa propozime për ndërrim destinim të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore, ndërsa dy pika janë shtyrë në mungesë kuorumi në mbledhje, të shkaktuar nga një pjesë e anëtarëve të kuvendit. Për këtë gjë ka reaguar edhe kryesuesi i KK të Malishevës, Azizi Thaçi, i cili, veprimet e një pjese të anëtarëve të kuvendit, i ka vlerësuar si veprime të papërgjegjshme.

Mbledhja e katërt e rregullt e KK të Malishevës, vazhdon të nesër e mërkure, 3 maj 2017, në ora 09:00.



KK i Malishevës, jep në shfrytëzim për një vit pishinat në Banjë

Malishevës, 3 maj



Kuvendi i Komunës së Malishevës, nën drejtimin e kryesuesit Aziz Thaçi, ka vazhduar sot punimet e mbledhjes së katërt, ku ka shqyrtuar dhe ka miratuar edhe disa çështje më rëndësi. Në mesin e shqyrtimeve dhe miratimeve, është edhe dhënia në shfrytëzim për një vit, të pishinave në Banjë, si dhe ka shqyrtuar raportin financiar për periudhën janar-mars 2017.

Fillimisht, anëtarët e KK, kanë miratuara kërkesën për ndërrimin e pronës publike me pronë private, për interes publik, më saktësisht për ndërtimin e një rruge në Malishevë. Më pas, KK, pas shqyrtimit, ka marrë vendim që të jep në shfrytëzim për një vit, pishinat në Banjë.

KK, gjithashtu sot ka shqyrtuar edhe raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-mars 2017, si dhe ka miratuar bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti fiskal 2015 dhe 2016, për vitin fiskal 2017. Gjithashtu në këtë mbledhje anëtarët e KK të Malishevës, janë informuar për punën e zyrës së tatimit në pronë, si dhe kanë shqyrtuar planin e punës së zyrës së prokurimit publik, për vitin 2017.

Pikat tjera të mbetura të mbledhjes së katërt, do të vazhdojnë në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Në ditën e shkollës, filloi ndërtimi i fushës së sportit në Turjakë

Malishevë, 5 maj

Sot në fshatin Turjakë, me rastin e shënimit të ditës së shkollës së fillore dhe të mesme të ulët, “Fehmi Agani”, ka filluar edhe ndërtimi i fushës së sportit, e cila do të jetë në shërbim të nxënësve dhe rinisë së fshatit. Në fillimin e punimeve të fushës së sportit dhe shënimit të ditës së shkollës, mori pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.



“Jemi munduar të krijojmë kushte sa më të mira për mësim, duke investuar në infrastrukturën shkollore në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës. Edhe vënia e gurëthemelit, për ndërtimin e fushës së sportit në shkollën tuaj, bëhet në kuadër të këtyre investimeve. Ndërtimi i fushës, ka qenë domosdoshmëri për nxënësit e kësaj shkolle, por edhe për rininë e fshatit”, tha mes tjerash kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në fjalën e rastit.

Kryetari Begaj, kërkoi nga mësimdhënësit që të jenë të angazhuar maksimalisht në rritjen e cilësisë në arsim.

Ndërtimi i fushës së sportit në Sh.F.M.U “Fehmi Agani” në Turjakë, financohet nga buxheti komunal i Malishevës.

Qendra e Kompetencës Malishevë, për shtatë vjet punë arriti të krijoj shkencëtarë

Malishevë, 5 maj



Në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, sot është mbajtur aktiviteti tradicional i panairit “dyert e hapura”, ku prezantohet puna dhe të arriturat e këtij institucioni të shkollimit të mesëm profesional. Në këtë panair, mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku.

Nënkryetari Mazreku, i ka uruar nxënësit, mësimdhënësit dhe menaxhmentin e kësaj shkolle, për organizimin e këtij panairi, ku nxënësit e të gjitha drejtimeve, i prezantojnë të arriturat dhe përgatitjen e tyre gjatë procesit mësimor.

Nga të arriturat e prezantuara, ishin edhe një zbulim i ri i një aparati për shpërndarjen e rrjetit pa tel të internetit, i krijuar nga nxënësit e degës së teknologjisë informative. Një e arritur tjetër e prezantuar, ishte suksesi në prezantimet



rajonale (Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni) i mbajtur kohë më parë në Prizren, ku nxënësit e kësaj qendre profesionale, janë vlerësuar me vendin e parë, në prezantimin e produkteve të tyre.

Maturantët e Malishevës, e përmbyllin javën e maturës, me plis në kokë

Malishevë, 5 maj

Java që po lëmë pas, ka qenë javë e maturantëve të Komunës së Malishevës, të cilët, gjatë tërë



javës kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme. Java e maturantëve është përmbyllur sot, me disa aktivitete tjera, përfshi edhe parakalimin e tyre nëpër qytet, ndërsa më e veçantë ka qenë bartja e plisit nga ana e maturantëve, si simbol shqiptar.

Pas parakalimit, në sheshin e qytetit është zhvilluar edhe një aktivitet tjetër, përkatësisht një program kulturo dhe artistik, i shoqëruar me muzikë.

“Është nderë dhe kënaqësi, të jesh para një gjenerate maturantësh. Maturant të dashur, ju kaluat me sukses një sfidë, në mesin e shumë sfidave që ju presin në të ardhmen”, ka thënë para maturantëve, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina, i cili i ka uruar maturantët dhe ju ka dëshiruar suksese në të ardhmen.

Ngricat e prillit, 27 fermerëve ju kanë bërë rreth pesëqind mijë euro dëme

Malishevë, 8 maj

Temperaturat e ulëta, që kanë mbretëruar gjatë muajit prill, kanë shkaktuar dëme të mëdha. Vetëm 27 fermerëve lokal, ju kanë shkaktuar dëme në vlerë prej rreth pesëqind mijë euro. Kështu u tha në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të cilën e drejtoi nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku.



Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, gjatë raportimit të tij, tha se “komisioni vlerësues, për dëmet e shkaktuara në bujqësi, si pasojë e temperaturave të ulëta, i ka vizituar të gjithë ata fermer të cilët janë ankuar dhe dëmet e vlerësuar janë 488.246 euro”. “Numri i fermerëve të cilët janë ankuar, është 27 fermer, të cilët janë ankuar për dëme në pemëtari, vreshtari, serra dhe të mbjella pranverore (misër), dhe vetëm tek këta fermer, është vlerësuar ky dëm. Dëmet duhet të jenë shumë fish më të mëdha, marrë parasysh faktin se fermerët, jo të gjithë janë ankuar”, tha drejtori Hoxha.

Përndryshe në mbledhjen e sotme, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, ka bërë të ditur, se kanë filluar përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Komunës së Malishevës.

Edhe drejtorët e drejtorive tjera komunale, ka raportuar për aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim.

Rregullohet infrastruktura në Carrallukë

Malishevë, 12 maj



Sot në fshatin Carrallukë të Komunës së Malishevës, ka filluar rregullimi i rrugëve në dy lagje të saj, ndërsa në të njëjtën kohë është duke u punuar edhe në rregullimin e kanalizimit brenda fshatit. Fillimin e rregullimit të rrugës dhe rregullimin e kanalizimit, e ka parë nga afër drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina.

Me këtë rast, drejtori Morina i ka uruar banorët e këtyre lagjeve për rregullimin e rrugës. “Hapja, rregullimi dhe asfaltimi i këtyre rrugëve janë pjesë e listës së investimeve të Komunës së Malishevës, të cilat janë planifikuara duke u bazuar në kërkesat e juaja si banorë të



fshatit. Gjithashtu edhe kanalizimi, është pjesë e këtyre investimeve dhe ne jemi të përkushtuar në rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme në të gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës”, tha drejtori Morina.

Sipas tij, momentalisht në Carrallukë janë duke u realizuar rreth dy mijë metra kanalizim, si dhe rrugë në gjatësi prej 700 metrave, dhe financohen nga buxheti komunal i Malishevës.

Drejtori Morina, gjithashtu ka bërë të ditur se tashmë punimet kanë filluar ose pritet të fillojnë në shumicën e projekteve, pasi janë kryer të gjitha procedurat për realizimin e projekteve nga lista e investimeve kapitale, për vitin 2017.

Begaj u takua me ambasadorin e Kuvajtit në Shqipëri

Malishevë, 12 maj



Ambasadori i Kuvajtit në Shqipëri, Fayez Mishari M. Al-Jassim, ka qëndruar sot në Malishevë, ku është pritur edhe nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Kryetari Begaj e ka falënderuar ambasadorin Al-Jassim, për këtë vizitë, si dhe kanë biseduar për rritje të bashkëpunimit dhe mbajtjes së kontakteve të vazhdueshme.

“Më vjen mirë që ju jeni sot këtu në Komunën e Malishevës” tha Begaj, duke shprehur kënaqësinë për vizitën e ambasadorit, të cilin më pas e ka njoftuar me Malishevën dhe rrjedhat e përgjithshme në Komunën e Malishevës.

Kryetari Ragip Begaj dhe ambasadori i Kuvajtit në Tiranë, Fayez Mishari M. Al-Jassim, u pajtuan për mbajtjen e kontakteve dhe për mundësitë e bashkëpunimit mes Komunës së Malishevës dhe shtetit të Kuvajtit.



Vazhdon realizimi i projekteve kapitale dhe rregullimi i infrastrukturës

Malishevë, 15 maj

Sot është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, të cilën e ka drejtuar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku. Në këtë mbledhje, u bë e ditur se është duke vazhduar realizimi i projekteve kapitale, sipas planifikimeve të bëra, dhe sipas listës së projekteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës.

“Dinamika e realizimit të projekteve po ecën sipas planit dhe afateve të parapara në asfaltimin e rrugëve nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës, si dhe kanalizimeve të cilat janë në fazën përmbyllëse”, tha drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina.

“Kjo dinamikë e realizimit të projekteve vazhdon me ritëm edhe në përmbushjen e kërkesave të blegtorëve të Komunës së Malishevës, ku pritet të subvencionohen edhe njëqind blegtor me makina mjelëse”, ka thënë drejtori i bujqësisë, Murat Hoxha, në raportimin e tij. Po ashtu, sipas Hoxhës, në fushën e perimtarisë dhe pemëtarisë, janë shtuar ankesat për dëmet që u sollën ngricat e prillit, fermerëve në Malishevë, ku përveç 27 fermerëve që u ankuan dhe u inspektuan më herët, ankuesit e tashëm, paraqesin dëmin në vlerë, prej tetëdhjetë mijë euro. Sipas Drejtorit, Murat Hoxha vazhdon edhe aksionin për përkujdesjen ndaj qenve endacak, të cilët po sjellin mjaft problem, e këtij problem i shtohet edhe paraqitja e sëmundjes “gungore”, te kafshët, ku për pasojë ka pasur edhe ngordhje të gjedheve.

Sipas drejtorit të Inspektoratit, nga sot ka filluar aksionit pesëditorë “T’i eliminojmë deponitë ilegale” të mbeturinave, në Komunën e Malishevës. Ky aksion realizohet në bashkëpunim me GIZ-in, ka bërë të ditur drejtori i inspektoratit Fadil Shala.

Filloi hapja dhe rregullimi i rrugës, që lidh Burimin dhe Gurbardhin

Malishevë, 15 maj



Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale dhe rregullimit të infrastrukturës rrugore, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës, e në veçanti për lidhjen e fshatrave përmes rrugëve të asfaltuara, ka filluar edhe hapja dhe rregullimi i rrugës, që lidhë fshatin Burim dhe Gurbardh.



Sot këtë rrugë, e ka inspektuar drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina, i cili ka parë nga afër punimet që janë duke u kryer në këtë rrugë dhe rrugët brenda fshatit Burim. “Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale, po bëhet hapja dhe rregullimi i kësaj rruge, deri në asfaltimin e saj,

pasi banorët e Burimit kanë pasur nevojë për këtë lidhje, me rrugën e Gurbadhit, por edhe me rrugën kryesore që i lidh këto fshatra me qendrën komunale”, tha Morina.

Drejtori Morina, po ashtu ka treguar se në Burim, do të rregullohen rreth një kilometër rrugë, ku përveç rrugës që e lidh këtë pjesë të fshatit me rrugën kryesore, do të rregullohen edhe rrugët në dy lagje tjera të fshatit.

Drejtoresha Krasniqi, uron atletet malishevase

Malishevë, 15 maj



Me rastin e suksesit të treguar nga atletet e Klubit të Atletikës “Malisheva”, në Kampionatin e Gjysmë Maratonës Ballkanike, Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, i ka uruar atletet nga Malisheva, të cilat e kanë përfaqësuar Kosovën në këtë garë prestigjioze, që është mbajtur dje në Prishtinë.

“Me rastin e suksesit të treguar të atleteve tona, Arbnore Berisha, nënkampione ballkanike, pastaj atleteve të reja Fortesa Berisha dhe Albulena Berisha, vendi i parë dhe vendi i tretë, në emër të Komunës së Malishevës dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, ju shprehi urimet më të sinqerta. Ju jeni



ato që na keni bërë të ndihemi krenar me juve. Ju treguat rezultate të shkëlqyera dhe uroj që të vazhdoni me këto suksese në arenën ndërkombëtare”, ka thënë mes tjerash, drejtoresha Blerta Krasniqi.

Sipas rezultateve zyrtare të Kampionatit të Gjysmë Maratonës Ballkanike dhe sipas trajnerit të Klubit të Atletikës “Malisheva”, Adrian Mazeku, vrapuesja Arbnore Berisha, së bashku me atleten, Luljeta Shala, si përfaqësuese të Kosovës, në konkurrencën ekipore, janë renditur në vendin e dytë, ndërsa vrapueset në kategorinë pioniere U16, në vrapimin dy kilometra, Fortesa Berisha është renditur e para, ndërsa Albulena Berisha e treta.

Përfunduan garat shkollore komunale në sport

Malishevë, 16 maj

Në organizim të Shoqatës së Pedagogëve të Sportit Shkollor (SHPSSH) të Malishevës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsimit dhe Edukim dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë dy muajve, janë mbajtur garat shkollore komunale në sport. Dje kanë përfunduar të gjitha garat dhe janë shpërblyer ekipet fituese. Në këtë ceremoni, kanë marrë pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, drejtoresha e DKRS-së, Blerta Krasniqi, drejtori i DSHMS-së, Hajdin Berisha dhe zyrtarët e DKAE-së.

Në këto gara kanë marrë pjesë rreth 1500 nxënës, të cilët kanë përfaqësuar shkollat në Komunën e Malishevës.

Me rastin e përfundimit të garave, nënkryetari Mazreku i ka përshëndetur dhe uruar të gjitha ekipet, apo shkollat fituese dhe ju ka dëshirua suksese në garat e mëtutjeshme.

Edhe Shoqata e Pedagogëve të Sportit Shkollor, i kanë falënderua të gjitha shkollat për pjesëmarrjen e tyre dhe për kontributin e dhënë në organizimin këtyre gara.

Shkolla e Berishës, shënoi 54 vjetorin e hapjes

Malishevë, 17 maj



Sot në fshatin Berishë, është shënuar dita e shkollës, përkatësisht 54 vjetori i hapjes së shkollës, e cila tani mbanë emrin e patriotit “Rifat Berisha”. Në këtë shënim të ditës së shkollës, morën pjesë, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, drejtori i arsimit Avdi Morina, familja e Rifat Berishës, dhe qytetarë të shumtë.

Pasi i ka uruar për ditën e shkollës, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, tha se “si qeveri komunale, jemi duke bërë përpjekje në përmirësimin e kushteve të mësimin, përmes investimeve në infrastrukturën shkollore. Këtë jemi duke e bërë edhe në Berishë, ku po ndërtojmë shkollën e re për nxënësit e kësaj ane”.

Me rastin e ditës së shkollës, edhe drejtori i arsimit në Malishevë, Avdi Morina, i ka uruar nxënësit dhe mësimdhënësit. Edhe drejtori Morina, tha se “si drejtori jemi duke u angazhuar maksimalisht në përmirësimin e kushteve për mësim dhe rritje të cilësisë në mësim”.

Për historikun e shkollës, foli drejtori i kësaj shkolle, Lulzim Gegaj, ndërsa më pas nxënësit e kësaj shkolle, dhanë edhe një program të pasur kulturor dhe artistik.

Kryetari Begaj, vizito punimet në Lladrovç e Llapçevë

Malishevë, 19 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina dhe ai i bujqësisë, Murat Hoxha, kanë vizituar disa nga punimet që janë duke u kryer në fshatrat e Komunës së Malishevës, e që lidhen me mirëqenien e qytetarëve, investime këto që ndikojnë në jetesën e tyre.

Sot janë vizituar punimet në hapjen dhe rregullimin e rrugëve në fshatin Lladrovç, ku kanë filluar punimet. Në këtë fshat, këtë vit, bazuar në listën e projekteve për investime



kapitale, përkatësisht në infrastrukturën rrugore, do të rregullohen 1 600 metra rrugë. “Përmes rregullimit të këtyre rrugëve, ne jemi duke bërë lidhjen e lagjeve me rrugën kryesore, pasi tashmë asnjë fshat i Komunës së Malishevës, nuk është pa shirit të rrugës e cila e lidh fshatin me qendrën komunale, por në disa fshatra kanë mbetur pa u lidhur lagjet me rrugët kryesore, siç është edhe Lladrovci”, tha Begaj.

Ndërsa në fshatin Llapçevë, janë duke u bërë shpime të thella për sigurimin e ujit për pije. “Sigurimi i ujit për pije është jetik për çdo banorë, dhe për këtë jemi duke u munduar që në çdo fshat të ketë ujë për pije, përkatësisht të sigurojmë burimet e ujit dhe të ndërtojmë sistemet e ujësjellësve” tha kryetari Begaj. “Ne përmes donacioneve kemi siguruar ujin për pije për një pjesë të madhe të Komunës së Malishevës, mirëpo disa nga fshatrat, ku përfshihet edhe Llapçeva, nuk mund të kyçen në atë sistemi dhe ne jemi të obliguar, që të sigurojmë ujin për banorët e Llapçevës, sikur edhe për fshatrat tjerë”, tha në fund Begaj.

Në Carrallukë, u përrua objekti i Shtëpisë së Kulturës

Malishevë, 19 maj

Sot, me një ceremoni, në fshatin Carrallukë, është përruar Shtëpia e Kulturës. Kjo është bërë e mundur falë përrtatjes së objektit të ish shkollës dhe donacioneve. Në këtë ceremoni, kanë marrë pjesë, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Bleta Krasniqi dhe drejtori i Drejtorisë për Arsimit dhe Edukim, Avdi Morina, si dhe donatori dhe humanisti Halim Hoti.

Me këtë rast, drejtoresha Krasniqi dhe drejtori Morina, i kanë uruar banorët e fshatit Carrallukë, për meremetim dhe përrtatjen e objektit, për nevojat e të rinjve të fshatit të tyre, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve kulturore dhe edukative.

Rregullimi i ish objektit të shkollës dhe shndërrimi i tij në sallë të kulturës, është mundësuar falë donacioneve nga humanisti Halim Hoti, i cili ka dhënë një donacion prej pesë mijë eurove dhe Komunës së Malishevës, e cila ka dhënë një donacion prej dy mijë eurove.



Komiteti për shëndetësi, vizitoi QKMF-në në Malishevë

Malishevë, 19 maj

Sot është mbajtur mbledhja e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e cila u drejtua nga kryetari i këtij komiteti, Veton Telaku. Në këtë mbledhje, anëtarët e komitetit, i kanë shqyrtuar disa çështje, e në mënyrë të veçantë, gjendja e përgjithshme në shëndetësi, dhe për këtë qëllim, edhe e kanë vizituar QKMF-në në Malishevë.

Anëtarët e Komitetit për Shëndetësi, gjatë vizitës në QKMF “Dr.Shpëtim Robaj” në Malishevë, janë takuar me menaxhmentin e këtij institucioni, ku janë njoftuar me të gjitha shërbimet që ofrohen, organizimin dhe kushtet e punës.

Drejtori i QKMF-së, Nuhi Morina, i ka njoftuar anëtarët e komitetit, për gjendjen në QKMF, angazhimin e stafit mjekësor, gjendjen dhe shërbimet në QMF-të dhe AMF-të, si dhe problemet dhe nevojat që ata kanë, në kryerjen dhe ofrimin e shërbimeve sa më profesionale për banorët e Komunës së Malishevës.

Shpërndahen njëqind makina mjelëse për fermerët malishevas

Malishevë, 22 maj

Në kuadër të investimeve të Komunës së Malishevës në bujqësi në përgjithësi, e në veçanti në blegtori, sot janë shpërndarë njëqind makina mjelëse, si pjesë e ndihmës së komunës për fermerët lokal. Në ceremoninë e shpërndarjes së këtyre makinave mjelëse, morën pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha.



“Çdo vit e më shumë jemi duke e përkrahur bujqësinë dhe për neve si qeveri komunale, investimet në bujqësi edhe në të ardhmen, do të



mbetet prioritet. Ne këtë vit kemi dhënë subvencione në ndërtimin e pesëdhjetë serave, tani po subvencionojmë njëqind fermer, me makina mjelëse dhe do të vazhdohet me dhënien e motokultivatorëve dhe subvencione tjera. E gjithë kjo e tregon më së miri përkushtimin tonë, për përkrahje dhe investime në fushën e bujqësisë”, tha mes tjerash Mazreku, i cili i uroi të gjithë fermerët, përfitues të makinave mjelëse.

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Blegtori, Murat Hoxha, tha se “janë njëqind përfitues të makinave mjelëse dhe qëllim i yni si drejtori dhe si qeveri komunale, është që fermerëve t’iu krijohen kushte sa më të mira dhe të kenë lehtësi, në këtë rast për mbajtjen dhe rritjen e numrit të lopëve qumështore”.

Filloi fushata e spërkatjes së zonave endemike në Malishevë

Malishevë, 22 maj



Sot, në Komunën e Malishevës, përkatësisht në fshatin Senik ka filluar realizimi i fushatës për dezinfektimin e zonave endemike, kundër rriqrave, si masë parandaluese në kuadër të zbatimit të strategjisë nacionale, për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK). Fushatën e spërkatjes së zonave endemike, e ka parë nga afër edhe shtabi komunal, për luftimin dhe parandalimin e EHKK.

Këtë fushatë, e kanë parë nga afër sot, anëtarët e shtabit komunal, nënkryetari i komunës, Rexhep Mazreku, drejtori i shëndetësisë, Hajdin Berisha, ai për mbrojtje dhe shpëtim, Sejdi Paçarizi dhe drejtori i bujqësisë, Murat Hoxha. Me këtë rast, nënkryetari Mazreku, ka kërkuar që qytetarët të jenë bashkëpunues gjatë kësaj fushate, pasi qëllimi i Komunës së Malishevës dhe të gjitha organeve tjera, është parandalimi i infektimit me virusin e etheve hemorragjike. “Falë këtij angazhimi të vazhdueshëm, tri vite i kemi kaluar pa raste të vdekjeve nga ky virus, prandaj, kërkoj që të jeni bashkëpunues dhe ti ndihmoni organet përgjegjëse, në mënyrë që këto fushata, përmes së cilave po e luftojmë këtë sëmundje, të kenë sukses sikur tri vitet e kaluara dhe të mos kemi më raste të vdekjeve”, tha Mazreku, i cili edhe ju dha mbështetje të gjithë atyre që janë të angazhuar në këto fushata.

Drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, tha se situata është nën kontroll dhe pavarësisht rasteve të thumbimeve, nuk kemi raste të infektuara me virusin e EHKK. “Edhe rastet e thumbimeve



janë më të pakta këtë vit, së paku deri në këtë periudhë, ndërsa komuna është e përkushtuar në luftimin dhe parandalimin e EHKK. Edhe kjo fushatë e dezinfektimit kundër rriqrave, financohet nga buxheti komunal i Malishevës, që tregon më së miri përkushtimin tonë, në mbrojtjen e jetës së njerëzve”, tha mes tjerash drejtori Berisha.

Vlen të theksohet se në Komunën e Malishevës, që nga pas lufta, kanë vdekur 18 persona si pasojë e infektimit me virusin e EHKK, ndërsa në tri vitet e fundit, nuk kemi asnjë rast të infektuar.

Njoftim: Prej nesër aparati i mamografisë në shërbim të qytetarëve të Malishevës

Njoftohen të gjithë të interesuarit, se nga dita e nesërme, e marte 23 maj 2017, në Malishevë, do të qëndroj aparati mobil i mamografisë dhe do të jetë në shërbim të të gjithë të interesuarve për kryerjen e këtij shërbimi shëndetësor.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Hajdin Berisha, aparati i mamografisë, që sot ka mbërritur në Malishevë, për dy javë, ose varësisht nga nevoja, do të qëndroj në shërbim të të gjithë atyre që duan të kryejnë këtë shërbim të kontrollit shëndetësor.

Të gjithë interesuarit, mund të paraqiten në QKMF të Malishevës, për bërjen e terminit për kryerjen e kontrollit me aparatit e mamogafisë. Paraqitja dhe shërbimi i kontrollit fillon nga ora 09:00 dhe do të jetë në shërbim të të interesuarve, çdo ditë pune, për dy javë, ose më shumë.

Askush nuk mund të kryej shërbimin, pa siguruar terminin në QKMF, si dhe duhet të ketë me vete dokumente identifikimi (letërnjoftim apo pasaportë), ndërsa mosha e lejuar për kryerjen e këtij kontrolli, është 40 vjeç e sipër.

KK i Malishevës, miratoi rishikimin e buxhetit komunal për këtë vit

Malishevë, 25 maj

Sot në një seancë urgjente, KK i Malishevës, ka mbajtur mbledhjen e saj, ku marrë disa vendime me rëndësi. Në mesin e këtyre vendimeve është miratimi i rishikimit të buxhetit komunal, për vitin 2017, si dhe formimi i Këshillit Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.



Përveç formimit të KO për shënimin e 16 Qershorit, KK miratoi edhe buxhetin për shënimin e kësaj date me rëndësi për Komunën e Malishevës.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, gjithashtu është informuar për Punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si dhe ka miratuar planin e punës për këtë vit, të këtij këshilli.

Plani i punës, është shqyrtuar edhe për njësinë e auditimit të brendshëm, si dhe është miratuar draft-Programi Komunal trevjeçar për banim, e po ashtu është miratuar edhe kërkesa e një qytetari për ndërrim destinim të pronës.

Sot, gjithashtu është shqyrtuar edhe peticioni i fshatit Lladrovç, për çështjen e ndërtimit të një gypi për ujitje dhe marrja e ujit nga një pemëtar. Anëtarët e KK të Malishevës, vendosën që të formojnë një komisionin, për bashkëbisedim mes banorëve të fshatit dhe pemëtarit.

BE përkrahë tri biznese në Malishevë

Malishevë, 25 maj



Tri biznese në Komunën e Malishevës, kanë përfituruar grante nga Bashkimi Evropian, në projektet e tyre për zgjerimin e biznesit ekzistues, apo si biznese fillestare. Ky donacion është bërë përmes ARDA, dhe sot edhe zyrtarisht këto tri biznese lokale, i kanë nënshkruar kontratat e përfitimit të donacioneve të tyre, përmes së cilave, do të zgjerojnë bizneset e tyre dhe rrjedhimisht edhe rritjen e numrit të të punësuarve.

Për këtë qëllim, sot në Malishevë, kanë qëndruar përfaqësuesit e ARDA, përkatësisht Nderim Bytyqi, drejtor i ARDA për rajonin e Prizrenit, me bashkëpunëtor, të cilët janë pritur nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, si dhe përfituesit e granteve të BE-së, i kanë nënshkruar kontratat.

Sipas Bytyqit, janë tri biznese të vogla nga Malisheva, të cilat kanë aplikuar dhe kanë prezantuar projektet e tyre, dhe janë projektet të cilat kanë përfituruar grante nga BE. “Shuma e përgjithshme e granteve, për të tri projektet është 27 392.80 euro.



Bazuar në grantet e Bashkimit Evropian për Kosovë, përkatësisht për përkrahjen e bizneseve të vogla, përfitues janë ato biznese të cilat kanë potencial të rritjes dhe përmes kësaj, krijohen edhe vende të reja pune.

Të tre përfituesit, i ka uruar edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. “Komuna nuk krijon vende pune, por ne krijojmë kushte për këtë dhe në kuadër të kësaj është edhe ky grant, që falë bashkëpunimit të komunës dhe ARDA-s, nga BE kanë përfituar këto biznese”, tha Begaj.

Malisheva, pjesë e “Projekti-Socio”

Malishevë, 26 maj

Komuna e Malishevës, përkatësisht Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dje ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi, me PREDA Plus Kosovë dhe ASB, me qëllim të zbatimit të projektit “Stabiliteti Socio-ekonomik i komuniteteve etnike pakicë dhe shumicë në Kosovës”.

Projekti “Stabiliteti Socio-ekonomik i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë”, i njohur si “Projekti – Socio”, është një nismë e financua nga “Engagement Global”, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim - BMZ dhe është duke u implementuar nga Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik - PREDA Plus Kosovë në partneritet me Arbeiter Samariter Bund - ASB.

Projekti synon të krijoj kushte të qëndrueshme të jetesës, si dhe kushte më të mira socio-ekonomik për familjet etnike të pakicave dhe të popullatës shumicë në Kosovë, përmes gjenerimit të të ardhurave, punësimit dhe mundësive të zhvillimit në komunitet.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, palët dakordohen që ekziston nevoja që të forcohen kapacitetet për bizneset fillestare, mikro dhe bizneset e vogla, pastaj forcimi i kapaciteteve të fermerëve, ngritja e kapaciteteve të shoqatave që mbështesin agrokulturën dhe ndërmarrësinë, krijimi i vendeve të reja të punës në bizneset ekzistuese dhe mbështetja e iniciativave të vogla që ndihmojnë zhvillimin e komunitetit.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është, që të siguroj një kornizë për bashkëpunimin e ardhshëm, në të mirë të zbatimit të suksesshëm të këtij projekti.



Nxënësit e klasave të nënta sot i nënshtrohen testit të arritshmërisë

Malishevë, 26.maj

Në mbledhjen e mbajtur të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina informoi anëtarët e komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport, që sot mbahet Testi i Arritshmërisë në Komunën e Malishevës, për nxënësit e klasave të nënta.

“Përgatitjet për mbarëvajtjen e testit të arritshmërisë, janë bërë me kohë nga ana e jonë. Për këtë kemi angazhuar, njëqind e njëzetë e gjashtë administrator (126), që do të monitorojnë njëmijë e treqind e shtatë nxënës (1307), të cilët i nënshtrohen testit të arritshmërisë”, tha drejtori Morina, i cili po ashtu i uroi që nxënësit të tregojnë suksese sa më të larta në testin e arritshmërisë.

Përndryshe, Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, por sot kishte planifikuar edhe vizita në shkollat e Komunës së Malishevës, por për shkak të mbajtjes së testit, janë anuluar këto vizita.

Komiteti për Komunitete, miratoi raportin e punës për vitin e kaluar

Malishevë, 26 maj

Komiteti për Komunitete, ka mbajtur mbledhjen e pestë të rregullt, për vitin 2017, dhe ka shqyrtuar dy raporte, si dhe ka dhënë një rekomandim për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës. Mbledhja e sotme, është drejtuar nga zëvendëskryesuesi i këtij komiteti Ismal Vrenezi.

Pas shqyrtimit të raportit të punës së Komitetit për Komunitete, anëtarët e këtij komiteti e kanë miratuar raportin e punës për vitin 2016, dhe të njëjtin raport e kanë rekomanduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës së Malishevës.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, ka raportuar edhe zyrtarja për komunitete dhe kthim, Edona Krasniqi, për punën tremujore (janar-mars). Bazuar në këtë raport, gjatë kësaj periudhe, janë riatdhesuar 12 persona nga Komuna e Malishevës, prej tyre 11 shqiptar dhe një nga komuniteti RAE. Pas paraqitjes së raportit, zyrtarja Krasniqi, është përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të këtij komiteti.



Kanalizimi në Mleqan, drejt finalizimit

Malishevë, 30 maj



Kanalizimi në fshatin Mleqan të Komunës së Malishevës, është drejt finalizimit, pasi komuna ka investuar edhe në një kilometër rrjet të kanalizimit në këtë fshat. Punimet në rrjetin e kanalizimit, i kanë inspektuar sot, i pari i Malishevës, Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi dhe drejtori i urbanizimit Ahmet Morina.

Punimet në ndërtimin e rrjetit të kanalizimit, janë futur në fazën finale dhe punimet janë

duke shkuar mirë, përderisa edhe banorët janë shprehur të kënaqur me cilësinë e punimeve.

Drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, tha se “janë rreth një mijë metra rrjet, në pjesët fshatit që nuk e kanë pasur të ndërtuar rrjetin e kanalizimit”. “Si qeveri komunale jemi duke punuar me ndërtim të rrjeteve të kanalizimit në disa vendbanime, sikur edhe në Mleqan dhe këto janë investime nga buxheti komunal i Malishevës”, tha Morina.

Familja Zogaj nga Llazica, bëhet më shtëpi të re

Malishevë, 30 maj

Familja e Mahmut Zogajt nga fshati Llazicë i Komunës së Malishevës, nga tani do të jetojë në shtëpi të re, pasi deri tani e kishte problem strehimin dhe jetonte në një shtëpi pa kushte normale të banimit. Familjen Zogaj, sot e kanë vizituar Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi dhe drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina.

“E gëzofshi shtëpinë e re. Uroj që të gjitha





të mirat të vijnë në familjen tuaj”, ka thënë kryetari Begaj, me rastin e vizitës, për hyrjen në shtëpinë e re, të familjes Zogaj. “Ne si komunë, çdo herë mundohemi që përmes përkrahjes konkrete ti ndihmojmë qytetarët e Komunës së Malishevës, përfshi edhe ata që e kanë problem sigurimin e banimit, dhe për këtë arsye ne kemi investuar në ndërtimin e shtëpive për këtë pjesë të shoqërisë sonë”, tha kryetari Begaj.

Familja Zogaj, është njëra prej pesë familjeve që iu është ndërtuar shtëpia, ku të tjerat, gjithashtu pritët që gjatë ditëve në vijim ti marrin çelësat e shtëpive të tyre. Komuna e Malishevës, ka ndërtuar pesë shtëpi për familjet në nevojë, si dhe shtatë pullaze për shtatë shtëpi tjera. Gjatë muajit të ardhshëm pritët të fillojnë procedurat edhe për ndërtimin e katër shtëpive tjera.

Parafilloristët, vizituan Drejtorinë për Arsim dhe Edukim Malishevë

Malishevë, 30 maj

Nxënësit e nivelit parafillorë nga SHFMU “Bajram Curri” në Drenoc, kanë vizituar sot objektin e Komunës së Malishevës, përkatësisht Drejtorinë për Arsim dhe Edukim (DAE). Ata janë pritur nga drejtori i DAE, Avdi Morina, i cili ju dëshiroi mirëseardhje dhe i përgëzoi mësimmshënëset edukatore, për punën dhe sukseset e arritura në këtë fundvit shkollor.

Mes tjerash, drejtori Morina, tha se “duke zbatuar kurrikulat mësimore, ku parashihet, korrelacionin lëndorë, apo mësimmshënënia e teorisë me praktikën, është realizuar edhe kjo vizitë”.

I pranishëm në këtë vizitë ishte edhe nënkryetari, Rezhep Mazreku, ku lavdëroi punët e bëra nga mësimmshënëset e këtij niveli në mbarë Komunën e Malishevës. Ai tha “se ç’do ditë e më shumë po plotësohen standardet në infrastrukturën shkollore dhe pajisja me mjete mësimore të nevojshme për implementimin e kurrikulës shkollore, që do të ndikoj drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në mësimmshënënie dhe mësimmshënënie”.

Filloi ndërtimi i rrugës që lidh dy lagje të Denocit

Malishevë, 30 maj

Sot në fshatin më të madh të Komunës së Malishevës, në Denoc, ka filluar hapja e rrugës që lidhë dy lagje të këtij fshati, lagjet Latifaj dhe Lacaj. Në fillimin e punimeve, krahas banorëve të



shumtë dhe udhëheqjes së fshatit, morën pjesë edhe drejtori i urbanizimit, Ahmet Morin, drejtori i shërbimeve publike, Milazim Morina, drejtoresha për kulturë, Blerta Krasniqi dhe anëtarja e KK të Malishevës, Arbëresha Krasniqi.



“Ne jemi të përkushtuar që të investojmë në projekte të cilat lidhen drejtpërdrejtë me jetën dhe mirëqenien e qytetarëve të komunës sonë, andaj edhe kemi filluar sot me ndërtimin e dy segmenteve të rrugëve, njëra që lidh dy lagjet dhe tjetra brenda lagjes Lacaj”, tha drejtori i urbanizimit Ahmet Morina.

“Kemi investuar dhe po bëjmë disa investime në Drenoc, si vendbanimi më i madh në Komunën e Malishevës, dhe këto investime janë në infrastrukturë, por sot unë mund të them lirisht, se të gjitha rrugicat në fshatin tuaj do të asfaltohen, për ta kompletuar infrastrukturën në fshat”, tha Ahmet Morina, drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit.

Fshati Drenoc, është vendbanimi më i madh në Komunën e Malishevës, ndërsa disa nga lagjet janë larg njëra tjetrës. Banorët e lagjeve Latifaj dhe Lacaj, i bëjnë disa kilometra për të shkuar nga lagjja në lagje, ndërsa me hapjen dhe rregullimin rrugës, deri në asfaltim, largësia mes lagjeve do të shkurtohet dukshëm dhe qarkullimi mes tyre do të jetë shumë më i lehtë. Kjo rrugë ka një gjatësi prej rreth 1200 metrave, ndërsa rruga tjetër në lagjen Lacaj, ka një gjatësi prej rreth 400 metrave, dhe ndërtimi i këtyre rrugëve, financohet nga buxheti komunal i Malishevës.

Filloi ndërtimi i shkollave në Lladrovç dhe Bardh

Malishevë, 31 maj

Sot në fshatin Bardh, ka filluar ndërtimi i shkollës së re të fshatit. Po ashtu edhe në fshatin Lladrovç, sot ka filluar ndërtimi i shkollës së re dhe të dy këto shkolla pritet të përfundojnë në vitin 2018. Lladrovci, gjithashtu sot, shënon edhe ditën e dëshmorëve të fshatit. Në vënien e gurëthemelit të shkollave, mori pjesë edhe Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i arsimit Avdi Morina dhe drejtorë tjerë të drejtorive komunale.



Me këtë rast, kryetari Begaj, i ka uruar, nxënësit, banorët dhe mësimdhënësit e të dy shkollave. “Qëllim i yni është rritja e cilësisë në arsim, por për rritjen e cilësisë duhet të krijohen edhe kushte për mësimdhënie dhe mësimnxënie, prandaj edhe ne si udhëheqje komunale, investimet në fushën e arsimit, përkatësisht në ndërtimin e objekteve shkollore, e kemi prioritet. Unë ju uroj për fillimin e

punimeve dhe uroj që ti gëzoni këto shkolla dhe në të njëjtën kohë, ne veçanti ju mësimdhënës, bashkë me nxënësit, uroj të tregoni rezultate”, tha mes tjerash Begaj. Në Lladrovc, kryetari Begaj, me rastin e ditës së dëshmorëve, ka bërë nderime pranë lapidarit të të rënëve.

Me rastin e fillimit të punimeve edhe drejtori i arsimit në Malishevë, Avdi Morina, i ka uruar banorët, nxënësit dhe mësimdhënësit e të dy shkollave.

Drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, tha se “shkolla në Bardh ka një hapësirë prej 1200 metra katrorë, ndërsa hapësira e shkollës në Lladrovc është 1500 metra katrorë”. Ndërtimi i shkollës në Bardh, do të kushtoj rreth 250 mijë euro, kurse ajo në Lladrovc, rreth 280 mijë euro dhe financohen nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Edhe familja Sertolli bëhet me shtëpi banimi

Malishevë, 31 maj

Familja e Halime Sertollit, nga tani, përfundimisht e ka zgjidhur problemin e banimit, pasi shtëpia e saj është e gatshme për banim. Këtë shtëpi, familja Sertolli nga Bellanica, e ka donacion nga Komuna e Malishevës, në vazhden e projektit komunal për ndërtimin e shtëpive për familjet në nevojë dhe është njëra prej pesë përfituesve të





shtëpive.

Këtë familje e ka vizituar sot Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar edhe nga drejtori i urbanizmit Ahmet Morina dhe drejtori i bujqësisë Murat Hoxha, të cilët e kanë uruar kryefamiljaren Halime Sertolli, për shtëpinë e re.

“Nga viti i kaluar, ne kemi filluar ndërtimin e shtëpive për familjet të cilat e kanë problem çështjen e banimit, dhe sot jemi këtu, në këtë familje e cila është përfituese e këtij projekti dhe më nuk ka problem me banim. Ju si kryefamiljare dhe si e pa punë, deri më sot e keni pasur të vështirë të siguronit një banim komod për fëmijët, por tashmë nuk e keni këtë brengë. Uroj që ta gëzoni shtëpinë dhe të keni shëndet”, tha Begaj, me rastin e dorëzimit të çelësave të shtëpisë, për familjen Sertolli.

Kryetari Begaj, gjithashtu ka paralajmëruar, se edhe këtë vit, do të vazhdoj me të njëjtën formë të ndihmës për familjet të cilat jetojnë në kushte të rënda socio-ekonomike dhe e kanë problem çështjen e banimit.